



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 104/ Prot.

Tiranë, më 08.01. 2024

URDHËR

NR. 3, DATË 08.01.2024

PËR

**SHPLLJEN E THIRRJES PËR PROJEKT PROPOZIME NË FUSHËN E
SPORTIT, NGA FEDERATAT JOOLIMPIKE, PËR VITIN 2024**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 79/2017 “Për Sportin”, i ndryshuar, Urdhrit nr.564, datë 05.10.2023 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të Zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, Z. Endrit Hoxha”

URDHËROJ:

1. Shpalljen e thirrjes për projekt propozime në fushën e sportit, nga federatat joolimpike, për vitin 2024.
2. Federatat joolimpike aplikojnë për përfitim të financimit për projekt propozime në fushën e sportit për vitin 2024, në përputhje me treguesit e përcaktuar në “Udhëzuesin mbi thirrjen për projekt propozim në fushën e sportit, për vitin 2024”, sipas shtojcës nr. 1, dhe duke plotësuar formularin e aplikimit, sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij urdhri.
3. Afati i dorëzimit të dokumentacionit aplikues për projekt propozimet, do të jetë deri më datë 31.01.2024.
4. Vlerësimi i projekt propozimeve në fushën e sportit të federatave joolimpike do të bëhet nga Ministria përgjegjëse për sportin, në përputhje me treguesit e përcaktuar në “Udhëzuesin mbi thirrjen për projekt propozim në fushën e sportit, për vitin 2024”, shtojca nr. 1, pjesë përbërëse të këtij urdhri.

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Politikave të Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ENDRIT HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

SHTOJCA 1

**UDHËZUES MBI THIRRJEN PËR PROJEKT PROPOZIM NË FUSHËN E SPORTIT,
PËR VITIN 2024**

Ministria e Arsimit dhe Sportit, në zbatim të nenit 13, të ligjit nr. 79/2017 “Për sportin”, të ndryshuar dhe pikës 4, të udhëzimit të përbashkët nr. 4, datë 25.02.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për mënyrën e përdorimit të fondit “Grand/transfertë korrente e brendshme”, për federatat sportive olimpike, Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Organizatën Kombëtare Anti-doping”, hap thirrjen për aplikime për projekte në fushën e sportit, duke mbështetur propozime të paraqitura nga Federatat sportive jo-olimpike, të regjistruara në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilat kanë në objekt të veprimtarisë së tyre promovimin e sportit masiv dhe elitë, promovimin e sportit për personat me aftësi të kufizuara, edukimin nëpërmjet sportit dhe promovimin e sportit shqiptar në arenën ndërkombëtare.

Thirrja do të qëndrojë e hapur deri më datë **31.01.2024**

Projekt-propozimet e paraqitura duhet të realizohen brenda vitit buxhetor, pra veprimtaritë e propozuara në kuadër të projektit duhet të zhvillohen brenda **vitit 2024**.

PRITORITET E THIRRJES JANË SI MË POSHTË:

- Promovimi i sportit shkollor;
- Promovimi i sportit universitar;
- Promovimi i sportit për personat me aftësi të kufizuara;
- Promovimi i sportit për të gjithë;
- Promovimi i sportit për gjithë përfshirje;
- Promovimi i veprimtarive në kuadër të marrëveshjeve midis federatave sportive dhe Ministrisë përgjegjëse për sportin, për masivizimin e sportit.
- Pjesëmarrja e sportistëve shqiptarë në arenën ndërkombëtare.

Fondet për financimin e projekteve do të jenë nga buxheti i shtetit në formë transferte.

**TIPOLOGJIA/LLOJET E VEPRIMTARIVE TË PRASHIKUARA NË KUADËR TË
PROJEKT PROPOZIMEVE**

Të gjitha veprimtaritë, të cilat kanë në fokus sportin dhe synojnë arritjen e prioriteteve të parashikuara mund të kualifikohen për financim ose bashkëfinancim.

VIZIBILITETI

Aplikantët duhet të ndërmarrin veprimet e nevojshme për të publikuar faktin që Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), ka financuar ose bashkë-financuar projektin, si edhe do të përdorin në çdo moment logon e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, duke bashkëvepruar me drejtorinë përkatëse përpara çdo publikimi për ruajtjen e logos së Ministrisë, si edhe të përdorimit të formulimit të mëposhtëm në çdo raste botimesh, kurdoherë që do të nevojitet: “Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësia e vetme e (emri i partnerit zbatues) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht mendimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë”.

VËMENDJE:

- Një Federatë mund të paraqesë **më shumë se një projekt propozim** në një aplikim të vetëm, në këtë thirrje për propozime.
- Në rast se gjatë zbatimit të projektit, rezulton dhe vërtetohet se ka patur paraqitje të dokumentacionit të rremë, të secilës prej dokumenteve të kërkuara në këtë thirrje, Ministria e Arsimit dhe Sportit, do të kërkojë kthimin e plotë të shumës së disbursuar dhe do ta dërgojë rastin për ndjekje penale, në bazë të legjislacionit në fuqi.
- Aplikanti ka për detyrë të aplikojë objektivat dhe prioritetet dhe garancitë e vizibilitetit, në përputhje me kërkesat e paraqitura në këtë shtojcë.

DOKUMENTET E KËRKUARA PËR APLIKIM

Në bazë të parashikimit të pikës 3, të nenit 17, të ligjit nr. 79/2017 “Për sportin”, të ndryshuar, Federatat aplikuese duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Përshkrim të veprimtarisë, të zhvilluar në përputhje me qëllimet dhe objektivat e përcaktuara në statutin e saj, si dhe referuar prioriteteve të thirrjes;
2. Relacion narrativ mbi zhvillimin e Kampionatit Kombëtar dhe Kupës së Shqipërisë, për vitin 2023;
3. Relacion narrativ dhe financiar mbi përdorimin e fondeve në projektet e financuara nga MAS për vitin 2023 (në rast se ka patur financime);
4. vendimet e asamblesë vjetore të federatës për vitin 2023;
5. vendimet e asamblesë së fundit zgjedhore, të zhvilluar në respektim të ciklit olimpik.

Shoqëruar me:

6. Formularin e plotësuar të Projekt Propozimit (shtojca 2) – në formatin Word (Projekt propozimi i plotë, i shoqëruar me parashikimin e detajuar të buxhetit. Në rast se në aplikim paraqitet me shumë se një projekt ide, të paraqitet parashikimi i detajuar buxhetor për çdo projekt);

7. Statutin e federatës të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, sipas legjislacionit në fuqi, shoqëruar me Vendimin e Gjykatës kompetente për regjistrimin e ndryshimeve të tij, nëse ka;
8. Dokumentin e regjistrimit në organin tatimor (NIPT);
9. CV-të e anëtarëve të grupit të punës, përgjegjës për zbatimin e projektit;
10. Konfirmim për bashkëfinancimin e projektit të propozuar (nëse ka);
11. Të dhënat e llogarisë bankare.

Shënim: *Mungesa e dokumentacionit të kërkuar më sipër, s'kualifikon automatikisht aplikantin nga procesi i trajtimit të aplikimit për financim/bashkëfinancim të projekteve të propozuara, për thirrjen e vitit 2024.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

THIRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIME NË FUSHËN E SPORTIT
2024

SHTOJCA 2

FORMULAR APLIKIMI

PJESA I: INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Titulli i projektit 1	
Prioriteti i Thirrjes ku aplikohet	(Klik kutinë) Promovimi i sportit shkollor <input type="checkbox"/> Promovimi i sportit universitar <input type="checkbox"/> Promovimi i sportit për personat me aftësi të kufizuara <input type="checkbox"/> Promovimi i sportit për të gjithë <input type="checkbox"/> Promovimi i sportit për gjithëpërfshirje <input type="checkbox"/> Promovimi i veprimtarive në kuadër të marrëveshjeve midis federatave sportive dhe Ministrisë përgjegjëse për sportin, për masivizimin e sportit <input type="checkbox"/> Promovimi i arritjeve sportive shqiptare në arenën ndërkombëtare. <input type="checkbox"/>
Titulli i projektit 2	
Prioriteti i Thirrjes ku aplikohet	(Klik kutinë) Promovimi i sportit shkollor <input type="checkbox"/> Promovimi i sportit universitar <input type="checkbox"/> Promovimi i sportit për personat me aftësi të kufizuara <input type="checkbox"/> Promovimi i sportit për të gjithë <input type="checkbox"/> Promovimi i sportit për gjithëpërfshirje <input type="checkbox"/> Promovimi i veprimtarive në kuadër të marrëveshjeve midis federatave sportive dhe Ministrisë përgjegjëse për sportin, për masivizimin e sportit <input type="checkbox"/> Promovimi i arritjeve sportive shqiptare në arenën ndërkombëtare. <input type="checkbox"/>
Titulli i projektit 3	
Prioriteti i Thirrjes ku aplikohet	(Klik kutinë) Promovimi i sportit shkollor <input type="checkbox"/> Promovimi i sportit universitar <input type="checkbox"/> Promovimi i sportit për personat me aftësi të kufizuara <input type="checkbox"/> Promovimi i sportit për të gjithë <input type="checkbox"/> Promovimi i sportit për gjithëpërfshirje <input type="checkbox"/>

	Promovimi i veprimtarive në kuadër të marrëveshjeve midis federatave sportive dhe Ministrisë përgjegjëse për sportin, për masivizimin e sportit <input type="checkbox"/> Promovimi i arritjeve sportive shqiptare në arenën ndërkombëtare. <input type="checkbox"/>
Titulli i projektit 4	
Prioriteti i Thirrjes ku aplikohet	(Klik kutinë) Promovimi i sportit shkollor <input type="checkbox"/> Promovimi i sportit universitar <input type="checkbox"/> Promovimi i sportit për personat me aftësi të kufizuara <input type="checkbox"/> Promovimi i sportit për të gjithë <input type="checkbox"/> Promovimi i sportit për gjithëpërfshirje <input type="checkbox"/> Promovimi i veprimtarive në kuadër të marrëveshjeve midis federatave sportive dhe Ministrisë përgjegjëse për sportin, për masivizimin e sportit <input type="checkbox"/> Promovimi i arritjeve sportive shqiptare në arenën ndërkombëtare. <input type="checkbox"/>
Emri i Aplikantit	
Statusi ligjor (së bashku me ndryshimet që kanë pësuar aktet themelore të organizatës, duke bashkëngjitur vendimet përkatëse të gjykatës, Nr.)	<i>Numri i Vendimit dhe Data e regjistrimit në Gjykatë;</i> <i>NIPT-i</i> <i>Emri i Bankës</i> <i>Numri IBAN</i> <i>Nr. i Llogarisë Bankare (në lekë)</i>
Adresa:	
E-mail:	
website:	
Kohëzgjatja e projektit	< datë/muaj nga / deri >
Vendi/-et ku zbatohet projekti (bashki/qark)	
Personi i kontaktit	
Pozita në organizatë	
Buxheti Total:	
Fondet e Kërkuara nga MAS:	
Informacion për bashkëfinancim (emri-shuma) nëse ka.	
Partnerët e Projektit:	

Shtoni hapësira në formular, në rast se në aplikim paraqiten me shumë projekte të propozuara.

PJESA II VLERËSIMI ME PIKËZIM I PROJEKTIT

Projektet e paraqitura do të vlerësohen deri në 100 pikë në total, sipas treguesve të mëposhtëm.

1. Përshkrim të veprimtarisë, që zhvillohet në përputhje me qëllimet dhe objektivat e përcaktuar në statutin e saj, si dhe referuar prioriteteve të thirrjes; (deri në 20 pikë)

2. Përshkrimi i përgjithshëm i projektit, referuar impaktit social, ekonomik dhe mjedisor (deri në 20 pikë)

Përshkruani shkurtimisht qëllimin e projektit, problematikën që ai adreson, si dhe argumentimin se si projekti u përgjigjet nevojave të identifikuara në përputhje me prioritetin e zgjedhur të thirrjes.

(maksimumi 10 rreshta).

[Shpjegoni...]

3. Objektivat e projektit (maksimumi 5 rreshta për secilin objektiv): (deri në 20 pikë)

1. [Shpjegoni...]

2. [Shpjegoni...]

3. [Shpjegoni...]

4. Veprimtaritë kryesore të projektit (maksimumi 5 rreshta përshkrim për secilin aktivitet, të planifikuara në çdo fushë) (deri në 10 pikë)

1. [Shpjegoni...]

2. [Shpjegoni...]

3. [Shpjegoni...]

4. [Shpjegoni...]

Etj.

5. A janë veprimtaritë e propozuara të përshtatshme, praktike dhe në përputhshmëri me objektivat dhe rezultatet e pritura? (Maksimumi 5 rreshta): (deri në 10 pikë)

[Shpjegoni...]

Veprimtaria 1: Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Shpjegoni...]

Veprimtaria 2: Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Shpjegoni...]

Veprimtaria 3: Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Shpjegoni...]

(mund të shtohen në vazhdim për veprimtari të tjera nëse ka)

6. **Cili është grupi ose cilat janë grupet e synuara?** *(Lutemi të përshkruani shkurtimisht, në mënyrë sa më të përmbledhur, se cili është grupi parësor i synimit të projektit dhe se si kanë për t'i shërbyer aktivitetet e projektit.) Maksimumi 5 rreshta: [Shpjegoni...]*
(deri në 10 pikë)

7. **Qëndrueshmëria e projektit** – impakti afatgjatë i projektit nga pikëpamja e problematikës së adresuar, fushës së zhvillimit të projektit, si dhe individit ose organizatës që e propozon.
(deri në 10 pikë)

Maksimumi 5 rreshta:

PJESA III: PARTNERËT (NËSE KA)

Bashkërendimi i punës midis partnerëve. *(Përshkruani natyrën e partneritetit. Shpjegoni bashkërendimin e punës midis partnerëve duke përshkruar procesin e vendimmarrjes, si dhe funksionin dhe përgjegjësitë e secilit partner në zbatimin e projektit.) Maksimumi 5 rreshta: [Shpjegoni...]*

Partneri 1 (Aplikanti)

Misioni. Cili është misioni i organizatës tuaj?

Maksimumi 5 rreshta: [Shpjegoni...]

Struktura. Përshkruani strukturën e organizatës duke përfshirë detaje, si numrin e të punësuarve dhe strukturën e menaxhimit.

Maksimumi 5 rreshta: [Shpjegoni...]

Financimi. Si financohet organizata juaj dhe cili ishte buxheti i saj për vitin paraardhës?

Maksimumi 5 rreshta: [Shpjegoni...]

Partneri 2

Emri organizatës: [Shpjegoni...]

Personi i kontaktit: _____

E-mail: _____

Adresa: _____

Faqja në internet: _____

Shtoni hapësira në formular, në rast se në aplikim paraqiten më shumë se një projekt propozim.